



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2020

**“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9669, DATË 18.12.2006,
“PËR MASAT NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Fjalja hyrëse e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Si rregull, mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, do të sigurohet duke larguar menjëherë të paditurin (dhunuesin/en) nga banesa për një

afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës. Përveç kësaj mase, mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji sigurohet në këto mënyra: ”

2. Shkronja “c” shfuqizohet.

3. Shkronjat “m” dhe “m/l” shfuqizohen.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përveç masës që parashikohet në pikën 1 të këtij, mund të parashikohen disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në shkronjat “a” deri në “ll” të pikës 1 të këtij neni”.

4. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendimin e gjykatës, përveç masës që parashikohet në pikën 1 të këtij neni mund të parashikohen disa nga masat e parashikuara në shkronjat “a” deri në “ll” të pikës 1 të këtij neni”.

Neni 2

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1 Rehabilitimi i dhunuesit

1. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate udhërohet dhunuesi/ja, të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale dhe/ose në programe të aftësimit prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private.

2. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit raportojnë përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij, në mënyrë periodike si dhe në përfundim të programit, në të cilin të përfshihen rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit. Nëse dhunuesi/ja nuk merr pjesë në program, atëherë, me kërkesë të mbledhjes ad-hoc të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje ose të subjekteve të parashikuara nga neni 13, i këtij ligji, zbatohen dispozitat e Kodit Penal, për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për urdhrat e mbrojtjes.

3. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate urdhërohet i/e padituri/a ose dhunuesi/sja, nëse është rasti, të marrë pjesë në programe rehabilitimi, pranë qendrave spitalore, qendrave ambulatorie ose qendrave komunitare, që japin shërbime të shëndetit mendor, shërbime të alkoologjisë ose shërbime të toksikologjisë.

4. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit vënë në dijeni koordinatorin vendor pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje për pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij.”

Neni 3

Në nenin 13/1, pika 2, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” si më poshtë:

“ë) urdhërimin për largimin e dhunuesit/es nga banesa derisa gjykata të nxjerrë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes”.

Neni 4

Në nenin 24 shtohet një fjali si më poshtë:

“Në çdo rast, punonjësi i policisë ku paraqitet për mbrojtje viktime e referon rasti në organin e prokurorisë për ndjekjen penale të dhunuesit”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Handwritten signature and date: 10.01.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ .01.2020

Lënda: Nismë ligjore për amendimin e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar

Drejtuar: **Z. Gramoz RUÇI**
KRYETAR I KUVENDIT

K Ë T U

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës, dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendi të Kuvendit, paraqesim për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar,

Bashkëlidhur lutem gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionit shoqërues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETËT

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)

Handwritten signature of Klotilda Bushka

EGLANTINA GJERMENI

Handwritten signature of Eglantina Gjermeni